bontet

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVO-REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS
SKUPŠTINA REPUBLIKE KOSOVA
ASSEMBLY OF REPUBLIC OF KOSOVO
Zyra për Propozime dhe Parashtreso-Kancelarija za Predloge i Predstavke-Table Office
Nr. Prot / Br. Prot / Prot. No: 06/191/Do-145
Nr. i faqeve / Broj stranica / No. pages:
Data / Datum / Date: 27.10.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA - PRISTINA

# Republika e Kosovës
## Republika Kosovo-Republic of Kosovo
### Kuvendi - Skupština - Assembly

| PËR / ZA / TO | Kryeministër i Republikës së Kosovës Ramush Haradinaj | DATË DATUM DATE | 27.10.2017 |
|---|---|---|---|
| | | Reference | |
| NGA / OD / FROM | Donika Kadaj, deputete e GP Lëvizja VETËVENDOSJE! | | |
| SUBJEKTI PREDMET SUBJECT | Pyetje për përgjigje me gojë | | |

**Në bazë të Rregullës 45 pika(2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëjë pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.**

**Çështja:**

Z. Haradinaj, gjatë një interviste në emisionin "New Bugajski Hour", në televizionin publik keni thënë se "çështja e kufirit është një situatë shumë e papërshtatshme", "jemi në këtë realitet".

**Pyetja Parlamentare:**

Intervista e juaj është shumë e paqartë e sidomos kur ia shtojmë faktin se thatë që nuk pritni mrekulli që t'i kemi dy të tretat. Meqë kanë ndodhë shumë zhvillime të tjera, a mund të na tregoni se në cilën fazë ka mbërri komisioni i ri për demarkacionin?

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO-REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS
SKUPŠTINA REPUBLIKE KOSOVA
ASSEMBLY OF REPUBLIC OF KOSOVO
Zyra për Propozime dhe Parashtresa-Kancelarija za Predloge i Predstavke-Table Office
Nr. Prot. 06/195/Uo-148
Data 30.10.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA - PRISTINA

# Republika e Kosovës

## Republika Kosovo-Republic of Kosovo

## Kuvendi - Skupština - Assembly

| PËR / ZA / TO | z. Shyqiri Bytyqi<br>Ministër i MASHT-it | DATË<br>DATUM<br>DATE | 30.10.2017 |
|---|---|---|---|
| | | Reference | |
| NGA / OD / FROM | Ismajl Kurteshi<br>Deputet i GP Lëvizja VETËVENDOSJE! | | |
| SUBJEKTI<br>PREDMET<br>SUBJECT | Pyetje për përgjigje me gojë | | |

Në bazë të Rregullës 45 pika(2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëjë pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

**ÇËSHTJA: Vonesat në furnizimin e shkollave me ditarë.**

Z. Ministër, në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar, viti shkollor filloj pa ditar, pa fletore të punës dhe pa tekste shkollore. Mungesa e këtyre mjeteve të punës në shumë shkolla zgjati mbi një muaj. Shumë objekte shkollore, fillimi i vitit të ri shkollor i gjeti duke u riparuar për çka edhe u shty fillimi i mësimit në ato shkolla me javë të tëra.

**PYETJE PARLAMENTARE**: Z. Ministër, cilat janë arsyet e këtyre vonesave dhe çka keni ndërmarr ndaj atyre që i kanë shkaktuar këto vonesa të cilat ju kanë sjell dëme të pariparueshme nxënësve në të gjitha nivelet e shkollimit në Republikën e Kosovës?

KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS
SKUPŠTINA REPUBLIKE KOSOVA
ASSEMBLY OF REPUBLIC OF KOSOVO
Nr. Prot. 06/221/Uo-165
Data 02.11.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA - PRISTINA

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**
**Kuvendi - Skupština - Assembly**

| **PËR / ZA / TO** | *Zv. Kryeminister dhe Minister i Punëve të Jashtme* *z. Behgjet Pacolli* | **DATË DATUM DATE** | **02.11.2017** |
|---|---|---|---|
| **NGA / OD / FROM** | *Deputetja Evgjeni Thaçi Dragusha* | | |
| **SUBJEKTI PREDMET SUBJECT** | Pyetje për përgjigje me gojë | | |

Në bazë të nenit 45 pika(2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëjë pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

Çështja:

I nderuar Ministër:
Muajin e kaluar, përmes mediave kemi percjellur viziten në Turqi të delegacionit të Kosovës, të kryesuar nga ju. Në takimin që kishit me homologun tuaj z. Mevlut Cavushoglu, ky i fundit kërkoi nga autoritetet e Kosovës që edhe në Kosovë të luftohet organizata e Fethullah Gulenit.

Pyetje :
I nderuar zv. Kryeminister dhe Minister i Punëve të Jashtme, cili është qendrimi i Qeverisë së Kosovës ndaj kësaj kërkese të autoriteteve Turke për luftimin e Levizjes Gulen?

Me respekt,
Evgjeni Thaçi Dragusha
Deputete

REPUBLIKA KOSOVO-REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS
SKUPŠTINA REPUBLIKE KOSOVA
ASSEMBLY OF REPUBLIC OF KOSOVO
Zyra për Propozime dhe Parashtresa-Kancelarija za Predloge i Podneske-Table Office
Prot. No: 06/222/Do-166
Date: 02.11.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA - PRISTINA

# Republika e Kosovës

## Republika Kosovo-Republic of Kosovo

### Kuvendi - Skupština - Assembly

| PËR / ZA / TO | Kryeministrin e Kosovës<br>z.Ramush Haradinaj | DATË<br>DATUM<br>DATE | 02.11.2017 |
|---|---|---|---|
| | | Reference | |
| NGA / OD / FROM | Imet Rramani, Deputet i Grupit Parlamentar të LDK-së | | |
| SUBJEKTI<br>PREDMET<br>SUBJECT | Pyetje Parlamentare | | |

**Në bazë të Rregullës 45 pika (2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëj pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës së Kuvendit të Kosovës.**

**Çështja:** Kryeministër, ju jeni të njohur me problemin e shqiptarëve të shpërngulur nga trojet e veta në Kosovën Lindore. Tash po bëhen 18 vite që mijëra qytetarë të dëbuar me dhunë nga Serbia nuk po munden të realizojnë të drejtat e tyre në Republikën e Kosovës. Shumica e tyre tashmë kanë krijuar pasuri me djersën e tyre, kanë shtëpitë, kanë bizneset, kanë krijuar familje, por nuk kanë mundësi të rregullojnë të drejtën për nënshtetësi, ku e drejta për nënshtetësi nuk po ju njihet edhe fëmijëve që kanë lindur dhe janë rritur në Kosovë.

Pytja: Z. Kryeministër, meqenëse e keni edhe premtim elektoral, dua të na përgjigjeni se cili është plani i juaj dhe cilat hapa i keni ndërmarur deri tash në zgjidhjen e problemit të shqiptarëve nga Kosova Lindore për realizimin e të drejtës për nënshtetësi?

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVO-REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS
SKUPŠTINA REPUBLIKE KOSOVA
ASSEMBLY OF REPUBLIC OF KOSOVO
Zyra për Propozime dhe Parashtresa - Kancelarija za Predloge i Predstavke-Table Office
Nr. Prot.
Br. Prot.
Prot. No: 06/233/Do-167
Nr. i faqeve
Broj strana
No. pages
Data
Datum
Date: 02-11-2017
PRISHTINË - PRIŠTINA - PRISTINA

# Republika e Kosovës
## Republika Kosovo-Republic of Kosovo
### Kuvendi - Skupština - Assembly

| PËR / ZA / TO | Uran Ismaili<br>Ministër i Shëndetësisë | DATË<br>DATUM<br>DATE | 02.11.2017 |
|---|---|---|---|
| | | Reference | |
| NGA / OD / FROM | Imet Rramani, Deputet i Grupit Parlamentar të LDK-së | | |
| SUBJEKTI<br>PREDMET<br>SUBJECT | Pyetje Parlamentare | | |

Në bazë të Rregullës 45 pika (2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëj pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës së Kuvendit të Kosovës.

**Çështja:** Minister, ka kohë që procedurat e prokurimit për Projektin e Spitalit të Përgjithshëm të Ferizajit kanë përfunduar. Ministria e Shëndetësisë dhe komuna e Ferizajit kanë pasur një angazhim shumë serioz në hartimin e projektit dhe zhvillimin e procedurave të parapara me ligj për fillimin e ndërtimit të Spitalit në Ferizaj.

Ka kohë, që Ministria e shëndetësisë ka pranuar përgjigjen definitive nga OSHP. Lënda po mbahet në zyret e prokurimit dhe nuk po procedohet për lidhje të kontratës.

**Pyetja:** Z.Ministër pse po zvarritet lidhja e kontratës dhe fillimi i punëve për ndërtimin e Spitalit të Përgjithshëm të Ferizajit

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVO-REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS
SKUPŠTINA REPUBLIKE KOSOVA
ASSEMBLY OF REPUBLIC OF KOSOVO
Zyra për Propozime ... Kancelarija za Predloge i Predstavke-Table Office
06/229/Do-168
Data / Datum / Date: 03.11.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA - PRISTINA

Republika e Kosovës
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
**Kuvendi - Skupština - Assembly**

---

**PËR:** Ministrin e Shëndetësisë, z. Uran Ismaili

**NGA:** Dr. Vjosa Osmani – Sadriu, Deputete GPLDK

**DATA:** 3.11.2018

**LENDA:** Pyetje parlamentare

---

Në bazë të nenit 45 të Rregullorës së Punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, në seancën e radhës së Kuvendit, shtroj këtë pyetje parlamentare për të marrë përgjigje nga Ministri i Shëndetësisë i Republikës së Kosovës, z. Uran Ismaili.

**Çështja:** Asambleja Botërore e Shëndetësisë, si organi më i lartë i OBSH-së, mbanë takime të rregullta çdo vit dhe është organi suprem vendimmarrës që vendosë me shumicë votash për anëtarësimin e një shteti të ri në këtë Organizatë. Duke ditur rolin që mund të ketë anëtarësimi në OBSH në cilësinë e shërbimeve shëndetësore për qytetarët e Republikës se Kosovës, sidomos në fushën e përafrimit të standardeve më të mira të shëndetësisë me këtë organizatë, është e pritshme nga Ministria e Shëndetësisë, ajo e Jashtme, Zyra e Kryeministrit dhe ajo e Presidentit të bëjnë koordinimin dhe lobimin e duhur për anëtarësimin në këtë organizatë. Kontaktet janë poashtu të nevojshme me shtete njohëse dhe ato jo-njohëse për të kërkuar mbështetje për anëtarësim (përmes vizitave, lobimit direkt dhe indirekt, letrave dhe mesazheve, telefonatave, angazhimit të ambasadave të Kosovës, koordinimit të aktiviteteve me ambasadat e shteteve mike, etj). Mungesa e një koordinimi të tillë, njejtë siç ka ndodhur edhe me anëtarësimin në UNESCO para dy viteve, dhe prapë në UNESCO dhe INTERPOL këtë vit, dëmton mundësinë që Kosova të aplikojë për anëtarësim vitin e ardhshëm.

**Pyetja:** A ka bërë Ministria e Shëndetësisë koordinimin e nevojshëm për anëtarësim në OBSH dhe a planifikohet anëtarësimi ne OBSH gjate vitit 2018. A është kjo kohë e mjaftueshme për të përgatitur tërë këtë proces? A është ngritur ndonjë komision ndërministror ose ndërinstitucional i cili do të merrej në mënyrë specifike me anëtarësimin në OBSH dhe nëse po, cilat institucione janë të përfshira aty?

Me respekt,

Vjosa Osmani-Sadriu

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVO-REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS
SKUPŠTINA REPUBLIKE KOSOVA
ASSEMBLY OF REPUBLIC OF KOSOVO
Zyra për Propozime dhe Parashtresa-Kancelarija za Predloge i Predstavke-Table Office
Nr. Prot / Br. Prot / Prot. No: 06/230/00-169
Nr. i fageve / Broj strana / No. pages:
Data / Datum / Date: 03.11.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA - PRISTINA

# Republika e Kosovës

## Republika Kosovo-Republic of Kosovo

## Kuvendi - Skupština - Assembly

| PËR / ZA / TO | z. Shyqiri Bytyqi<br>Ministër i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë | DATË<br>DATUM<br>DATE | 03.11.2017 |
|---|---|---|---|
| | | Reference | |
| NGA / OD / FROM | Frashër Krasniqi<br>Deputet i Grupit Parlamamentar të Lëvizjes VETËVENDOSJE! | | |
| SUBJEKTI<br>PREDMET<br>SUBJECT | Pyetje për përgjigje me gojë | | |

**Në bazë të Rregullës 45 pika(2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëjë pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.**

**Çështja:** Përshkrimi paragjykues dhe diskriminues në librat shkollorë i personave me Sindromin Down.

**Pyetja parlamentare:**

Z. Minister, a jeni të informuar mbi raportimet e mediave në lidhje më përshkrimin paragjykues dhe diskriminues që u bëhet personave me Sindromin Down, në librat shkollorë dhe a keni ndërmarrë diçka në lidhje me këtë çështje?

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVO-REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS
SKUPŠTINA REPUBLIKE KOSOVA
ASSEMBLY OF REPUBLIC OF KOSOVO
Zyra për Propozime dhe Pareshtresa-Kancelarija za Predloge i Predstavke-Table Office
Nr. Prot / Br. Prot / Prot. No: 06/234/Do-173
Data / Datum / Date: 06.11.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA - PRISTINA

# Republika e Kosovës

## Republika Kosovo-Republic of Kosovo

### Kuvendi - Skupština - Assembly

| PËR / ZA / TO | *Ministrin e Shëndetësisë*<br>*z.Uran Ismaili* | DATË<br>DATUM<br>DATE | 06.11. 2017 |
|---|---|---|---|
| NGA / OD / FROM | *Deputetja Ganimete Musliu* | | |
| SUBJEKTI<br>PREDMET<br>SUBJECT | Pyetje për përgjigje me gojë | | |

Në bazë të nenit 45 pika(2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëjë pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

Çështja:
I nderuari Ministër:
Infermieret të cilat kanë përfunduar fakultetin e infermierisë në Kosovë paguhen me koeficientin e njejtë sikurse infermiere me shkollë të mesme.

PYETJE :
I nderuari Ministër:
A keni paraparë ngritjen e koeficeintit për infermieret të cilat kanë kualifikim universitarë?

KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS - SKUPŠTINA REPUBLIKE KOSOVA - ASSEMBLY OF REPUBLIC OF KOSOVO
Nr. Prot. 06/235/DO-174
Data 06.11.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA - PRISTINA

# Republika e Kosovës
## Republika Kosovo-Republic of Kosovo
## Kuvendi - Skupština - Assembly

| | | | |
|---|---|---|---|
| **PËR / ZA / TO** | *Ministrin e Shëndetësisë z.Uran Ismaili* | **DATË DATUM DATE** | 06.11. 2017 |
| **NGA / OD / FROM** | *Deputetja Ganimete Musliu* | | |
| **SUBJEKTI PREDMET SUBJECT** | **Pyetje për përgjigje me gojë** | | |

Në bazë të nenit 45 pika(2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëjë pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

Çështja:
I nderuari Ministër:
Duke pas parasysh që në rastet emergjente siç janë: aksidentet në trafik, zjarrëvëniet apo aksidentet të natyrave të tjera me rrezikshmëri të lartë, të parët që arrijnë në vendin e ngjarjes para policisë dhe zjarrëfiksëve janë punëtorët mjekësor të ndihmës së parë.

PYETJE :
I nderuari Ministër:
Marrë parasysh rrezikshmërinë e lartë në punë kur këta punëtorë do të paguhen për shkallën e rrezikshmërisë?